

“ISHA BULLIZUES”

i Andrea Franzosos

SKEDA 3

KAPITULLI 7-8-9

“vjedhja ne banke”

Pse Danieli dhe Maksimi në një moment të caktuar mendojnë të grabisin një bankë?

- Për shijen e aventurës.
- Sepse duan shumë para.
- Sepse duan që të bëhen më të fuqishmit në Kuarto Oxharo.

Mëngjesin e grabitjes, Maxim vëren se Danieli ka frikë: me çfarë shenjash “fizike” shfaqet kjo gjendje shpirtërore?

Brenda Danielit dëgjohej një zë i vogël që i thotë të kthehet dhe ta lërë atë punë, por ai ia mbyll gojën. Shëno me një kryq mendimet që e shtojnë të vazhdojë.

- Dua t'u tregoj të gjithëve se çfarë jam i aftë të bëj.
- Dua ta mërzis nënën time.
- Sot më në fund do të blej një RefrigiUear.
- Nuk mund ta zhgënjej Marikën.
- Nuk mund të tregohem i dobët përpara Maksimit.

Cilat janë gjërat e para që blen Danieli me paratë e grabitjes? Pse janë kaq të rëndësishme për të?

Fjalët janë të rëndësishme

1. Djali rom me të cilin Danieli zihet quhet “Patrik cigani”. Termi cigani, i cili në të kaluarën përdorej zakonisht, sot konsiderohet përcjues; Më mirë të përdoret fjala rom. Bëj një kërkim mbi popullsitë nomade: nga vijnë ata? Cila është historia e tyre?

2. Në ngatërresën midis Patrikut dhe Danielit del në pah një tjetër fyerje raciste: “zezak”, një fjalë që tani ka vetëm një kuptim fyes. Në vend të kësaj, përdoret

3. A e dini se çfarë do të thotë “politikisht korrekt”? Dhe çfarë është cancel culture (kultura e përjashtimit)? Bëni një kërkim dhe diskutoni në klasë.



Përcaktimi i ndjenjave

1. ANKTHI: është një shqetësim shumë i fortë, i përzier me frikë. Në libër krahasohet me “një gropë në stomak”; Disa e përshkruajnë si ndjesinë e pamundësisë për të marrë frymë. A ke përjetuar ndonjëherë ankth? Në çfarë situatë? Si e ke mbarështuar atë?

2. HIDHËRIMI: është një keqardhje shumë e fortë. Pas njërit prej debateve të tyre, e ëma i hedh atij “një vështrim mes qortimit e hidhërimit”: pak e zemëruar, pak

Pse?

Ndoshta ka _____
sepse nuk ka bërë gjithçka të mundshme për të birin.
Pra, hidhërimi ka të bëjë me trishtimin dhe me inatin.

Reflektim personal:

DY GËNJESHTRA DHE NJË E VËRTETË

Me radhë, nxënësit shkojnë te katedra dhe i tregojnë klasës tri gjëra për veten e tyre. Për shembull, “Dëgjoj lajmet çdo ditë”, “Kam qenë në Afrikë”, “I bie kitarës”. Vetëm njëra nga të treja është e vërtetë. Shokët e klasës duhet të gjejnë se cila është ajo.

DEBAT: Organizimi i grabitjes ishte si të luash një videogame

Natën para grabitjes, Danieli dhe Maksimi shkuan për të parë nëse kishte kamera, një vend parkimi për skuterin dhe rrugë të mundshme të ikjes. Në këtë rrethanë Danieli mendon: “është si të luash një videogame”, por me një nivel adrenaline shumë më të lartë. Ndonjëherë, në fakt, **videolojërat** simulojnë veprime të paligjshme ose të dhunshme, të tilla si të shtënat, grabitjet, vrasjet. Dhe kjo është vetëm një nga arsyet pse ata shpesh gjykojnë si çedukative. Çfarë mendoni ju? A jeni dakord me këtë kritikë apo jo? Pse? A kanë videolojërat aspekte pozitive, përveç argëtimit? Ballafaqohuni dhe hapni një debat.

NDJENJA:

RESPEKTI

Në Kuarto Oxharo, për të fituar respektin e të tjerëve duhet të kryesh krime, të veshësh rroba firmato, të kesh një makinë të mirë; Danieli dhe Maksimi i synojnë këto gjëra për t'u bërë dikushi, për të rënë në sy, për të pasur autoritet në lagje. Kështu, Danieli "kishte keqkuptuar gjithçka". Për të, respekti fitohej duke ua futur tmerrin të tjerëve, por në realitet respekti i vërtetë nuk ka të bëjë fare me frikën, pasi ajo është një ndjenjë spontane dhe e lirë.

Shëno me një kryq fjalët afër konceptit të "respektit".

- Frikë
- Vlerësim
- Admirim
- Indiferencë
- Konsideratë
- Xheloz
- Zili

Sipas teje, si mund të fitohet respekti i të tjerëve? Përmes forcës, bukurisë, pasurisë? Apo nëpërmjet sjelljes, cilësive dhe çfarë tjetër?

Të rriturit: SHEMBUJ TË GABUAR

PIXHI është mjeshtër i grabitjeve, ai që ka arritur të fitojë disa para dhe tani ka një shtëpi në qendër të qytetit dhe një makinë të mirë. Për Danielin dhe Maksimin ai është një model për t'u ndjekur, një udhërrëfyes. Sa keq që i çon në rrugën e gabuar. Çfarë ndiejnë dy djemtë për të?

- Tërbim
- Zili
- Admirim
- Respekt
- Kureshtje
- Dashuri
- Frikë

GJYSHJA E MARIKËS është një tjetër personazh i lagjes, një grua e thjeshtë. Kur Marika dhe Danieli hyjnë në shtëpi ajo nuk i sheh. Pse? Ku është e përqendruar ajo? Çfarë mendon për sjelljen e saj?

Për cilët njerëz ke një respekt të veçantë? Çfarë admiron tek ata?

A je dakord me këshillën për të bërë injeksione për të eliminuar celulitin? Pse?

MEDIAT DHE RRJETET SOCIALE propozojnë modele që ndonjëherë na kushtëzojnë negativisht. Në ç'menyrë? Diskutojeni në klasë.

NJË TRUP QË NDRYSHON AQ SHPEJT

"Marrëdhënia e Marikës me trupin e saj ishte shumë e vështirë": shikohej në pasqyrë dhe nuk i pëlqente vetja, e shihte veten plot me të meta, në fund të fundit e konsideronte veten të shëmtuar. Ndoshta të ka ndodhur edhe ty, si shumë adoleshentëve të tjerë. Në këtë periudhë të jetës, në fakt, trupi ndryshon aq shpejt sa është e vështirë që të mësohesh me të; për shembull, vajzat bëhen gra, djemve u ndryshon zëri dhe jo të gjithë e përjetojnë "metamorfozën" në të njëjtën kohë. Disa vuajnë sepse janë ende të vegjël, të tjerë sepse janë rritur përpara të tjerëve, dhe secili prej tyre duhet të përballlet me pamjen e vet. Gjëja e rëndësishme është që të kuptojmë se, përtej pamjes së jashtme, të gjithë janë të bukur për atë që janë, për veçantinë e tyre dhe mund të pëlqehen pikërisht për origjinalitetin e tyre. Ajo që i fiton ose i neverit vërtet njerëzit është mënyra jonë se si i krijojmë marrëdhëniet me ta, mënyra jonë e të bërit të gjërave, personaliteti ynë.

Kjo nuk e heq faktin se, veçanërisht në adoleshencë, është shumë e rëndësishme që të kujdesemi për trupin tonë dhe të bëjmë një jetë të shëndetshme. Si? Duke ngrënë mirë dhe duke lëvizur shumë.

1. Çfarë do të thotë sipas teje "të hash mirë"? Cilat janë ushqimet e shëndetshme? Mendo për historinë e Danielit: çfarë ha ai zakonisht? Çfarë do t'i këshillonit të ndryshonte në zakonet e tij? Pse?

2. Çfarë do të thotë "mirëqenie"? Për të qenë mirë, nuk mjafton të kesh një trup të shëndetshëm: për të qenë mirë, është gjithashtu e nevojshme që mendja të jetë e kthjellët, e qetë. Përveç shëndetit, është e rëndësishme që të jesh mirë. Cilat janë gjërat që të bëjnë të ndihesh mirë? Cilat janë situatat ose aktivitetet që të japin gëzim, hare dhe lumturi?